



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

**KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS**

**I.Numër:463-01/36017, dt. 28Maj 2024.**

Në bazë të nenit 11 dhe nenit 12. 2. pika (d) të Ligjit Nr. 03/L – 040 Për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28.datë: 04. Qershor 2008”), nenit 53 paragrafi 1 i Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës /Nr. 20/21 Qershor 2016) dhe nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4 të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës, 01.Numër: 09 – 8103 dt.30. Shtator 2020, bazuar në vlerësim të ligjshmerisë së MAPL-së, Nr.020-165/1, dt. 12.03.2024 për Vendimin Nr.03/2024 të dt. 27.02.2024, në rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur me datë: 28 Maj 2024, merr, këtë:

**VENDIM**

**Nr.14/2024**

**Mbi Shfuqizimin e Vendimit Nr. 03/2024 me nr.protokolli 400-01/11637, të datës 27.02.2024 të Kuvendit të Komunës së Pejës**

- I. **SHFUQIZOHET** – Vendimit nr. 03/2024 me nr.protokolli 400-01/11637, datë 27 shkurt 2024 K.K. Pejë mbi miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të Avdyl Çetaj me qëllim të realizimit të shtegut të ecjes buzë Lumit’’Lumbardhë’’ dhe ndërtimit të rrugës ‘’Maja Zezë’’ sipas PZHK.
- II. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohet Vendimi nr. 03/2024 dt.27 shkurt 2024 me nr.protokolli 400-01/11637 datë 27 shkurt K.K. Pejë mbi miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunes për Këmbimin e Pronës Komunale me Pronën private dhe nuk prodhon efekt juridik.
- III. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Çështje Pronësoro –Juridike.
- IV. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe 7 (shtatë) pas publikimit në web faqen e Komunës së Pejës.

**Vendimi ti dërgohet:**  
MAPL-së,  
Kryetarit të Komunës,  
DÇPJ,  
Arkiv.

